

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala- anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NSHIMB “NN”, me seli në Gjilan, të cilin e përfaqëson XH.S., përfaqësues i Agjensionit Kosovar të Privatizimit- Zyra në Gjilan, kundër të paditurit T.S., nga Gjilani, rr.“...”, me objekt të padisë pagesë e borxhit, vlera e kontestit 585.56 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.10/10, të datës 26.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit T.S. nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.10/10, i datës 26.11.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.10/10, të datës 26.11.2013, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit NSHIMB “NN”, me seli në Gjilan, ndërsa e ka obliguar i padituri T.S., që paditësit t’ia paguajë shumën prej 500 euro, në emër të qirasë se papaguar për dy muaj, prej 01.06.2008 e deri me 31.07.2008, për lokalin afarist nr.27/1, si dhe shpenzimet e energjisë elektrike në shumë prej 85.56 euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 585.56 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe nëse nuk anulohet të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, përmes së cilës ka propozuar që në tërësi të refuzohet ankesa e të paditurit si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë në tërësi të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurit është **e pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në gjykatën e shkallës së parë paditësi me datën 18.01.2010, ka paraqitur padi për pagimin e borxhit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t’ia paguajë borxhin paditësit sipas marrëveshjes për qira e lokalit afarist nr.27/1, me datë 22.02.2008, prej datës 01.03.2008 e gjerë me datë 31.08.2008, në shumë

prej 500 euro me kamatë ligjore, poashtu t'ia kompensoj paditësit shumë prej 85,56 euro sipas bazës së pasurimit të pabazë me kamatë ligjore, sidhe detyrohet të paguajë borxhin në tërësi në shumë prej 585.56 euro si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka caktuar shqyrtimin kryesor, ka administruar provat materiale të propozuara nga palët ndërgjyqëse dhe atë: marrëveshjen mbi qiranë nr.27/1, kartelën e kontabilitetit, kartelën e KEK-ut për shpenzimet e energjisë elektrike, procesverbalin e datës 08.08.2008 dhe vërejtjen e datës 27.06.2008. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të cekura më lartë, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.10/10, të datës 26.11.2013, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se nga provat e administruara ka rezultuar se palët ndërgjyqëse kanë pasur një marrëdhënie kontraktuese të qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist në Gjilan në shumë mujore të qirasë prej 250 euro. Më tutje ka shtuar se ka rezultuar që i padituri nuk e ka kryer pagesën e qirasë për muajin qershor dhe korrik të vitit 2007, si dhe nuk i ka paguar shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën e cekur më lartë, për çka edhe është obliguar që të paguajë shumë e cekur në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit sa i përket asaj se ai nuk ka pranuar asnjëherë padi apo shkresa të tjera të lëndës së padisë nga gjykata, pasi fakti i pranimit të shkresave të cekura më lartë është e vërtetuar përmes fletëdorëzimeve të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe të nënshkruara nga i padituri dhe atë: fletëdërgesa për dorëzim personal, përmes së cilës të paditurit i janë dorëzuar padia me prova së bashku me aktvendimin për përgjigje në padi, të cilën i paditur e ka nënshkruar me datë 02.02.2010, në bazë të të cilave edhe ka prashtruar përgjigje në padi me datë 15.02.2010, si dhe fletëdërgesa për dorëzim personal përmes së cilës i padituri e ka pranuar ftesën për shqyrtim kryesor të datës 26.11.2013, të cilën i padituri e ka pranuar me datë 13.11.2013.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që me dispozitën e nenit 148 paragrafi 1 të LMD-së (i vitit 1978) përcaktohet se *”kontrata krijon*

të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese”, ndërsa me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 parashihet se “kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”. Në rastin konkret ekzistonte kontrata për shfrytëzimin e lokalit afarist pronë e paditësit, e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse, nga përmbajtja e sëcilës rezultonte obligimi i qirasë për shfrytëzimin e afarist për muajt kontestues, është shuma e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë përmes aktgjykimit të atakuar. Në anën tjetër pala e paditur nuk ka dëshmuar me prova para gjykatës së shkallës së parë se këtë shumë financiare në emër të qirasë ti ketë paguar paditëses.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitat e nenit 195.1, pika d) dhe nenit 200, të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.73/14, datë 02.08.2018

Kryetari i Kolegjit,
Lumni Sallauka